



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.05

Prishtinë, më 21.11.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj dhe Verica Qeraniq.

Munguan: Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Përfaqësues të ftuar: *Anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë* - Shafi Gashi, Florim Isufi, Arjeta Miftari, Visar Haxhibeqiri, Doruntinë Matoshi dhe Bego Kululleri.

Përfaqësues të tjerë: Sanije Berisha – OSBE, Hilmi Demolli e Isuf Koci – KKTK dhe përfaqësues të medias.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.11.2017;**
- 3. Takim i Komisionit me anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.11.2017

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 7.11.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Takim i Komisionit me anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kryetari i komisionit, në fillim të mbledhjes, tha se komisioni ka ftuar anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me qëllim të informimit për punën e bërë nga ana e Këshillit, si dhe planifikimet e tyre. Fjala iu dha kryetarit të Këshillit.

Shafi Gashi, kryetar i Këshillit, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me funksionimin e Këshillit dhe sfidat me të cilat ballafaqohet në kryerjen e detyrave. Ai tha se me marrjen e mandatit Këshilli ka hartuar rregulloren e punës dhe akte të tjera nënligjore në bazë të të cilave kemi punuar. Si sfidë përmendi mungesën e stafit i cili parqet problem të madh në kryerjen e punëve.

Sa i përket gjendjes së Trashëgimisë Kulturore, tha se nuk është e mirë edhe për faktin që ka një ndarje të veçantë buxhetore mbi 2 milionë euro nga MKRS. Ai tha se momentalisht janë 23 asete në mbrojtje të përhershme dhe 1555 asete në mbrojtje të përkohshme. Gjendje jo e mirë është edhe në fushën e mosrespektimit të legjislacionit, jo vetëm të personave fizikë, por edhe të institucioneve. Rasti i fundit është në ndërtimin e autostradave. Asnjë nga institucionet nuk kanë pyetur nëse këto autostrada dëmtojnë objekte të Trashëgimisë Kulturore. Ai tha se me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe shpirtërore ka kërkuar nga Qeveria që të mundësojë ndërtimin e një depoje e cila do të ofrojë kushte adekuate për ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme, si dhe krijimin e një instituti për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Doruntinë Matoshi, si anëtare e këtij këshilli, komisionit i ka dorëzuar një shkresë me të cilën ka renditur parregullsitë dhe shkeljet që pretendon se janë bërë në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Florim Isufi tha se gjendja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë nuk është në nivelin e duhur, e sidomos trashëgimia kombëtare e cila mendon se është lanë pas dore.

Ismajl Kurteshi tha se nga diskutimi i kryetarit të këshillit u vërejtën më tepër ankesa që kanë të bëjnë me mungesën e stafit dhe çështjet të tjera të brendshme se sa për punën e bërë nga ana e këshillit. Ai kërkoi sqarim lidhur me atë se çfarë ka bërë këshillin për çështjet e ngritura sa i përket kërkesës për ndërtimin e depos, investimeve në Prizren, raportet me MKRS, projektet kapitale infrastrukturore, si dhe Qendrave të Trashëgimisë Kulturore në qytete të ndryshme. Kryetari në vazhdim kërkoi sqarim nga ana e këshillit edhe për sa i përket shkresës që i është adresuar komisionit lidhur me parregullsitë në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore që kanë të bëjnë me mos prezantimin e të gjeturave të raportit të auditorit, mos diskutim i raporteve

financiare, mos respektim i rregullores lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së udhëheqësit ekzekutiv, keqpërdorim i postës elektronike etj.

Teuta Haxhiu tha se shkresat e dërguara nga disa anëtarë të këshillit në adresë të komisionit janë të paligjshme dhe nuk do të merremi me to. Ajo tha se përkundër kompletimit të bordit është shqetësuese që Këshilli është marrë me çështje personale, e jo me çështjet profesionale për të cilat janë emëruar. Ajo tha se do të propozojë shkarkimin e këshillit, pasi që nuk arriti të funksionojë si duhet.

Mufara Sinik kërkoj sqarim lidhur me restaurimin e shtëpive që janë në mbrojtje e në të cilat aktualisht jetojnë qytetarët në Prizren dhe lidhur me problematiken e investimeve nga MKRS.

Arbërie Nagavci tha se çështjet që u ngriten dhe shkresat që ne kemi pranuar flasin për probleme subjektive dhe shpreson që në afatin e paraparë të kemi një raport të detajuar për punën e Këshillit. Ajo ngriti çështjen e caktimit të ushtruesit të detyrës së udhëheqësit ekzekutiv, si dhe çështjen jo kompetent për këtë pozitë.

Nezir Çoçaj tha se edhe pse nuk po shqyrtohet një raport pune i këshillit, konsideron se komisioni do të ketë parasysh shqetësimin e ngritura dhe do të bashkëpunojmë në këtë aspekt.

Shafi Gashi u përgjigj në çështjet e ngritura rreth çështjes së depos për të cilën tha se është bërë kërkesë në MKRS, sa i përket ndërtimit të autostradave tha se ka reaguar në vazhdimësi për dëmtimin e trashëgimisë, ka takime të rregullta me MKRS dhe departamentet përkatëse, Qendrat e Trashëgimisë Kulturore, ndërsa sa i përket vendimit për caktimin e ushtruesit të detyrës së udhëheqësit ekzekutiv tha se është bërë mbi bazën e legjislacionit në fuqi.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi